

MBI
AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË
KOMUNËN DAJT, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar të kryer në Komunën Dajt, me objekt: *“Mbi aktivitetit ekonomik e financiar dhe kontrollin e brendshëm, zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet me fonde publike për mallra e shërbime, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, shitjen e trojeve, dhënie me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj.”*, për llojin e auditimit *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 158, datë 21.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 708/7, datë 21.12.2013, i ka rekomanduar z. Kujtim Qefaliaj, Kryetar i Komunës Dajt Tiranë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

Zyra e Taksave dhe Tarifave:

1. Të kryej parashikim real të të ardhurave vendore mbështetur në dhënat aktuale dhe realizimeve të mëparshme, duke i parashikuar analitike, për çdo lloj detyrimi.

2. Të hartoj regjistrin themelor të subjekteve fizikë, juridik dhe abonentëve familjarë, për të gjitha llojet e taksave dhe tarifave vendore si taksën, e biznesit, ndërtesës, pastrimit, gjelbërimit etj, në zbatim të nenit 3 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”* i ndryshuar.

3. Të hartojë planin vjetor për ushtrimin e kontrolleve me drejtime të përcaktuara, në zbatim të pikës 10 *“Kontrolli tatimor”*, të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 6.2.2007 *“Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”*.

4. Të njoftojë të gjithë abonentëve familjarë dhe jo familjarë, mbi detyrimet që ata kanë për taksat dhe tarifatat vendore, në zbatim të nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Lokale”* i ndryshuar.

5. Në bashkëpunim me Policinë e Komunës dhe Zyrën e Financës, të evidentoj subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelarisë dhe subjektet që shfrytëzojnë hapësira publike për qëllime biznesi e mbi këtë bazë të llogarisë detyrimet përkatëse dhe të kërkojë në rrugë administrative e ligjore arkëtimin e debitorëve për 29 raste me një vlerë prej 3,727 mijë lekë.

7. Në bashkëpunim me Zyrën e Financës të evidentojë, saktësojë dhe të paraqesë në kontabilitet subjektet debitorë në fund të periudhave ushtrimore deri në vitin 2013, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*.

Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor:

8. Të marrë të gjitha hapat ligjorë, duke kërkuar edhe mbështetjen e policisë së Shtetit dhe të INUK-ut, për të bërë të mundur zbatimin e vendimeve për prishje të objekteve pa leje.

9. Në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë, për të dërguar në “ Shërbimin Përmbartimorë” urdhër ekzekutimet e vendim gjobave, për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave që nuk janë arkëtuar.

10. Të ushtrojë kontrole në të gjitha objektet për të cilat Sektori I Planifikimit të Territorit ka dhënë leje ndërtimi, duke mos përjashtuar objektet me kate të ulëta. Për të rritur efektivitetin e punës dhe përgjegjësinë në punë të çdo inspektori të INUV-it , të bëhet një ndarje territoriale që çdo inspektor të mbulojë me aktivitet një zonë të caktuar, duke qenë përgjegjës për veprimtarinë e tij në këtë zonë.

11. Të hartojë regjistrat përkatës elektronikë, për të bërë të mundur regjistrimin e akteve të nxjerra, në veçanti për aktet e vendim gjobave. K/Inspektori i INUV të përditësojë regjistrin me të dhënat që do të marrë nga Sektori Juridik lidhur me ecurinë e vjeljes së gjobave.

12. Të dorëzojë në zyrën e arkivit të komunës, të gjitha dosjet e subjekteve ndërtuese që kanë përfunduar ndërtimin e objektit, që ka marrë lejen e Përdorimit dhe ka kaluar për regjistrim në ZRPP.

Zyra e Administrimit, Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës:

13. Në bashkëpunim me strukturat e tjera shtetërore të verifikojnë dhe saktësojnë gjendjen juridike dhe fizike të pasurive, të marrë nën administrim asetet, e llojit arë, ullishtë, vresht në sipërfaqen prej 30 ha, të ish-kooperativës bujqësore, t’i verë në efikasitet duke zbatuar procedurat ligjore të dhënies me qera të aseteve në varësi të Komunës. Të rillogariten dhe arkëtohen të ardhurat e munguara nga përdorimi i paligjshëm i tyre, në zbatim të VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.

Drejtoria Ekonomike:

14. Të marrë masa, për kryerjen e inventarizimit të aktiveve afatgjata, krahasimin me gjendjen kontabile dhe krijimin e regjistri i aktiveve të qëndrueshme, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

15. Të kontabilizojë në ditarin përkatës të magazinës vlerën prej 8,171,600 lekë për 5 studime e projekte të paguara nga komuna në vitin 2011 dhe 2012, në zbatim të nenit 13 pika të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

16. Në hartimin e buxhetit për vitin 2013 të përfshihen detyrimet afat shkurtra ndaj të tretëve të rezultuara nga mbyllja e bilancit të vitit 2011, në zbatim të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

17. Drejtoria e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Infrastrukturës dhe Drejtorinë Ekonomike, të bëjnë verifikimin dhe dokumentimin e vjeljes së gjobave dhe kryerjes së pagesës së taksave vendore të vendosura nga Këshilli i Komunës, për fazën e dhënies së lejes së përdorimit në 6 raste, në shumën 2,200,000 lekë dhe të marrin masa për kontabilizimin e tyre.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **8,132,820 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Vlera **600,000 lekë** Shoqatës “X”, e cila përfaqëson pagesë të tepërt për realizimin e projektit dhe aktivitetit kulturor në organizimin e festivalit rinor të nxënësve të shkollave të mesme të bashkive, kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004.
2. Vlera **210,672 lekë** subjektit “X” sh.p.k, e cila përfaqëson zbatimin e penaliteteve për çdo ditë vonese të dorëzimit të projektit, në kundërshtim me nenin 7 të Kontratës “Shërbim e Projektim” nr. 407, datë 16.02.2011 lidhur midis palëve.
3. Vlera **1,792,897 lekë** OE “X” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksion dhe sistemim asfaltim i degëzimit të rrugës Dajt – Lanabregas”.
4. Vlera **104,688** OE “X” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Muhamet Deliu (Fresku)”.
5. Vlera **386,936 lekë** OE “X & Y” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Chateau Linza- Shkozë”, për punime të pakryera në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998.
6. Vlera **1,026,788** lekë subjektit ndërtues “X” sh.p.k. për ndërtimin e objektit “Tre godina 3 dhe 5 kate + nënçati + 1 deri 4 kate nëntokë”.
7. Subjektit ndërtues “X” sh.p.k. vlerën **2,806,857** lekë për ndërtimin e objektit “Godina 4 kate + nënçati + 1 kate nëntokë”.
8. Subjektit ndërtues “X” sh.p.k. vlerën **251,602 lekë** për ndërtimin e objektit “Godina 2 kate + 1 kate nëntokë”, të cilat përfaqësojnë diferencën midis llogaritjes së “Tarifës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksës për financimin e studimeve urbanistike” 4 për qind mbi vlerën e preventivit të sjellë nga subjekti, ndaj llogaritjes me kosto mesatare të EKB bërë nga komuna.
9. Vlera **952,380 lekë** për pagesën e 11 anëtarëve të KRRT Komuna Dajt, si pagesë e pambështetur në dispozitat ligjore.

C. MASA ADMINISTRATIVE.

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë gjobë** për mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit **I.V.** në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt:

- “Rikonstruksion dhe sistemim asfaltim i degëzimit të rrugës Dajt - Lanabregas”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën 1,792,897 lekë, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punë të pakryer.
- “Rikonstruksion i Rrugës Chateau Linza- Shkozë”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën 386,936 lekë, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punë të pakryer.

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës, që bazuar në nenin 44 germa “I” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit si më poshtë:

“Largim nga puna”, neni 11 dhe 12 i kontratës individuale.

1. z. M.D. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore.

Për mosrealizim i të ardhurave nga taksave e tarifave vendore, të cilat janë realizuar 68 për qind në vitin 2011, 67 për qind në vitin 2012 dhe 37 për qind në 6 mujorin e parë të vitit 2013 dhe në veçanti realizmi shumë i ulët i taksës për “Zënieën e hapësirave publike”, i cili është 2 për qind për vitin 2011, për “Tokën bujqësore” në masën 11 për qind, “Biznesit të vogël” në masën 53 për qind në viti 2012.

Për parashikim jo real të të ardhurave vendore, duke mos u mbështetur në të dhënat korrente dhe realizimet e mëparshme, për çdo lloj detyrimi.

Për mos hartim të regjistrimit themelor të subjekteve fizikë, juridik dhe abonentëve familjarë, për të gjitha llojet e taksave dhe tarifave vendore si taksën, e biznesit, ndërtesës, pastrimit, gjelbërimit etj, në zbatim të nenit 3 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.

Për mos hartim plani vjetor për ushtrimin e kontrolleve me drejtime të përcaktuara, në zbatim të pikës 10 “*Kontrolli tatimor*”, të udhëzimit të përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 6.2.2007.

Për mos njoftim abonentët familjarë dhe jo familjarë, për detyrimet që ata kanë për taksat dhe tarifavat vendore, në zbatim të nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.

Për mos evidentim i subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në fushën e hotelerisë dhe subjektet që shfrytëzojnë hapësira publike për qëllime biznesi, mos zbatimit të procedurave të parashikuara në Kreu XI-*Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara*, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

Për mungesë kontrolli ndaj vartësve lidhur me rakordimin e të dhënave me DRT Tiranë, DSHTRR Tiranë, për taksën e regjistrimit automjeteve, Degën e Thesarin dhe Degën e Doganës Tiranë, për transaksionet e ndryshme që subjektet fizike kryejnë etj.

2. zj. DH.V. me detyrë inspektore e taksave vendore.

Për mos kryerjen e kontrolleve lidhur me rakordimin e të dhënave me DRT Tiranë, DSHTRR Tiranë, për taksën e regjistrimit automjeteve, Degën e Thesarin dhe Degën e Doganës Tiranë, për transaksionet e ndryshme që kryejnë subjektet fizike etj.

Për mos njoftimin e abonentëve familjarë dhe subjekteve fizikë, mbi detyrimet e taksave/tarifave vendore të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe gjobat për mos likuidim të detyrimeve, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

Për mos aplikimin e sanksioneve ndaj subjekteve debitorë, të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat/tarifavat vendore sipas periudhave, në zbatim të nenit 17, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008, Kreu XIV-*Sanksionet*, neni 114- *Mospagimi në afat*, në vlerën 931,750 lekë.

Për mos realizimin e të ardhurave nga taksave e tarifave vendore 68 për qind për vitin 2011, për vitin 2012 në masën 67 për qind dhe 37 për qind për 6 mujorin e parë të vitit 2013.

Për mos aplikimin e taksave/tarifave vendore ndaj subjekteve fizikë/juridikë, në kundërshtim me nenin 12, pika 4, e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, për 245 subjekte me vlerë 6,891,000 lekë, nga e cila taksa e ndërtesës në 12 subjekte me vlerë 247,900 lekë, taksa e pastrimit në 52 subjekte me vlerë 543,600 lekë, tarifa e gjelbërimit në 55 subjekte me vlerë 444,800 lekë dhe taksat/tarifavat vendore për vitet 2012 dhe 2013 të 126 subjekteve fizikë me vlerë 5,654,700 lekë.

Në mungesë të masave disiplinore të ndërmjetme në kontratën individuale dhe kolektive të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që për parregullsitë e konstatuara të marrë masat disiplinore të nevojshme për punonjësit:

1. z. H.SH. me detyrë inspektor i taksave vendore për:

Për mos planifikimin real të detyrimeve për taksën e tokës, ndjekjen në vazhdimësi dhe mos aplikimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo taksë për sipërfaqen e ndarë prej 1725.3 ha, me vlerë vjetore 1,118,280 lekë.

2. zj. H.A. me detyrë inspektore e taksave vendore,

3. zj. S.R. me detyrë inspektore e taksave vendore,

4. z. A.Q. me detyrë inspektor i taksave vendore,

5. z. Z.M. me detyrë inspektor i taksave vendore për:

Për mos kryerjen e kontroleve në subjektet fizikë dhe juridikë për monitorimin e xhiros së subjekteve, evidentimin hapësirave publike të zëna, sipërfaqen e ndërtimit me genplan, sipërfaqet e reklamave, mbajtjen e librit të xhiros, regjistrimin e faturave etj, në kundërshtim me pikës 10 “*Kontrolli tatimor*”, të udhëzimit përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 6.2.2007.

Për mos realizimin e të ardhurave nga taksave e tarifave vendore 68 për qind për vitin 2011, për vitin 2012 në masën 67 për qind dhe 37 për qind për 6 mujorin e parë të vitit 2013.

6. z. A.M. me detyrë ish-Inxhinier Pyjor.

Për mangësitë në administrimin dhe përdorimin efektiv dhe ekonomik të pyjeve dhe kullotave në dobi të komunitetit të kësaj komune, në zbatim të ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, pika 4 dhe VKM nr. 22, datë 09.1.2008. pikat 3, 4 etj.

Për mos kryerjen e inventarizimit kadastral pyjor, me synim përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore dhe aftësisë së funksionit mbrojtës për pyjet mbrojtës shtrirë në territorin e juridiksionin e komunës, në kundërshtim me nenin 5, 6 dhe 15 të ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005.

Për mos mbajtjen, evidentimin, administrimin dhe balancimin e fondit kullor, në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, neni 5, 7, 8, 9, 14 dhe 15.

7. z. A.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pasi ka llogaritur dhe arkëtuar më pak në tre raste taksën dhe tarifën e investimit në tre raste në shumën 4,085,247 lekë, për ndërtimin e objektit “Tre godina 3 dhe 5 kate + nënçati + 1 deri 4 kate nëntokë”, objektit “Godina 4 kate + nënçati + 1 kate nëntokë” dhe objektit “Godina 2 kate + 1 kate nëntokë”, të cilat përfaqësojnë diferencën midis llogaritjes së “Tarifës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksës për financimin e studimeve urbanistike” 4 për qind mbi vlerën e preventivit të sjellë nga subjekti, ndaj llogaritjes me kosto mesatare të EKB bërë nga komuna.

8. z. M.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, pasi ka paguar pa bazë ligjore anëtarët e KRRT-së Komuna Dajt për pjesëmarrje në mbledhje, në vlerën **952,380 lekë**.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Nga Komuna Dajt janë pranuar e vënë në zbatim rekomandimet e KLSH dhe është dërguar Plan masash për zbatimin e tyre me shkresë të protokolluar në KLSH nr. 708/10 datë 22.01.2014, pra rezulton se **rekomandimet janë pranuar**, dhe janë në marrë masat për zbatimin e tyre.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Alush Zaçe, Jonel Nasto, Luan Kuka dhe Kristaq Gjurgjaj, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT